



Pranuar / Dorezuar Punëjeto/Prejato Received/Delivered	24.12.2020	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSHICK	3304/2020		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr 358/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A. nr. 358/2020, të datës 13.11.2020, të parashtruar nga ankuesi ██████████, nga Komuna e Klinës, kundër organit të punësimit Komuna e Klinës, në çështjen juridike "kompensimi material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 24.12.2020 mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A. Nr. 358/2020 e datës 13.11.2020, e parashtruar nga ankuesi ██████████

A r s y e t i m

Ankuesi ██████████ i punësuar në Komunën e Klinës në pozitën "Zyrtar për Monitorim dhe Mbrojtje të Pyllit", në Drejtorinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural", me datë 13.11.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil, duke propozuar që Këshilli ta detyroj organin e punësimit që të nxjerrë akt administrativ lidhur me ngritje të hapit të pagës respektivisht koeficientit në pajtim me nenin 46 paragrafi 3 dhe neni 100 paragrafi 3 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 25.11.2020, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Komuna e Klinës, ndërsa me datë 04.12.2020 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me provat e bashkangjitura.

Administrimi i Provave: Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 13.11.2020 të parashtruar nga ankuesi në këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës: Kërkesën e datës 29.09.2020 me numër të protokollit 01/112-27938/2 drejtuar Kryetarit të Komunës së Klinës: Kërkesa e datës 03.08.2020 me numër të protokollit 01/120-19477/3, drejtuar

Kryetarit të Komunës së Klinës: Vendimi i datës 08.05.2012 me numër 01Nr.112-2224/2012 për rritjen e koeficientit të shërbyesve civil të administratës komunale të Komunës së Klinës: Vendimi i datës

02.02.2015 me numër 02Nr.120-714/2015 për ndryshimin e koeficientit për [REDAKTUAR] nga koeficienti 6 ne koeficientin 7: Shpallja e Rekrutimit e datës 06.08.2018 me numër 02Nr.111-5257/2018: Shpallja e rekrutimit e datës 21.11.2018 me numër 02Nr.111-7812/2018: Shpallja e Rekrutimit e datës 27.05.2019 me numër 02Nr.111-20739/2019 : Kërkesa për përgjigje në ankese e datës 25.11.2020 me numër të protokollit 2759/2020: Përgjigja në ankese e datës 04.12.2020 me numër të protokollit 2935/2020: Shpallja e Rekrutimit e datës 03.08.2017 me numër 02Nr.112-4031/2017: Opinioni i datës 17.07.2017 me numër të protokollit 06-226711 i Departamentit të Buxhetit lidhur me kërkesën për rekrutim te stafit, për Komunën e Klinës: Akte Emërimi i datës 20.12.2017 me numër 02Nr.112-6008/17: Ndryshimi dhe Plotësimi i Akt Emërimit i datës 30.10.2020 me numër 02Nr.112-31401/2020: Akte Emërimi i datës 20.12.2018 me numër 02Nr.112-8709/2018:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [REDAKTUAR], është e pa bazuar sepse:

Kolegji konstaton se janë plotësuar të gjitha kushtet për shqyrtimin e ankesës, në kuptim të pranueshmerisë së saj, siç përcaktohet me nenin 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon që ndjehet i diskriminuar në krahasim me kolegët, të cilët mbajnë të njëjtën pozitë profesional 2 të punësuar në administratën e Komunës së Klinës dhe kanë koeficientin 7 të pagës, ndërsa ankuesi ka koeficientin 5.5, dhe kërkon që ti bëhet ngritja e koeficientit në shtatë (7).

Sipas Akt Emërimit të datës 20.12.2018, ankuesi është i sistemuar në pozitën e punës "Zyrtar për Monitorim dhe Mbrojtje te Pyllit", në Drejtorinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural", me koeficient 5.5 të pagës, po ashtu me ndryshim dhe plotësim të Akt Emërimit të datës 30.10.2020, ka koeficienti page pesë pikë pesë (5.5). Ankuesi me datë 03.08.2020, i është drejtuar Kryetarit të Komunës së Klinës më kërkesë për ngritjen e koeficientit nga pesë pikë pesë (5.5) në koeficient shtatë (7). Ankuesi [REDAKTUAR] pas heshtjes se Kryetarit të Komunës lidhur me kërkesën e tij të datës 03.08.2020, përsëri me datë 29.09.2020, ka parashtruar kërkesë tek Kryetari i Komunës së Klinës, me të cilën kërkon nxjerrjen e aktit administrativ lidhur me ngritjen e koeficientit.

Ankuesi i pa kënaqur me heshtjen e vazhdueshme të Kryetarit të Komunës së Klinës lidhur me ngritjen e koeficientit, me datën 13.11.2020 ka parashtruar ankesën me numër protokollit 2589/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit janë në kundërshtim me nenin 9 paragrafi 1 të ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunëseve Civil, citoj: "Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara me aktin e kantatës së punës", në kuptim të kësaj, Kolegji vlerëson se ankuesi ka themeluar marrëdhënie te punës sipas Akt Emërimit 11-608/17 të datës 20.12.2017, të ndryshuar dhe plotësuar me datë 20.12.2018 dhe 30.10.2020, ku ankuesi ka pranuar koeficientin e pagës me vet aprovimin dhe nënshkrimin e Akt Emërimit si dhe ndryshimeve në këtë Akt Emërim.

Kolegji vlerëson së çdo procedurë për harmonizim dhe klasifikim te vendeve të punës dhe koeficienteve të pagës është përgjegjësi e organeve te punësimit dhe si e tillë duhet të zhvillohet në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm lidhur me pagat dhe klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtim dhe vendosje të ankesave ka konstatuar se ankesa e ankuesit është në kundërshtim më me nenin 7 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil i cili përcakton " Udhëheqësit e institucioneve të administratës publike ia propozojnë gradat e pozitive në institucionin e tyre ministrisë përgjegjëse për administratë publike, në bazë të rekomandimeve të personit përgjegjës për burime njerëzore në institucionin e tyre, i cili është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe procedurave për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. 2. Grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financat", bazuar në këto rrethana, Kolegji vlerëson se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pa bazuara.

Andaj, Kolegji mbështetur në gjendjen faktike dhe bazën juridike të lartcekur, e pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda Nr. A. Nr.358/2020

Ilire Mehmeti-SHAQIRI

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit [REDACTED]
- Kryetarit të Komunës së Klinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Klinës;
- Arkivit të KPMSHCK-së,

